



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 16.1, shkronja **i** dhe të nenit 59, shkronja **a** të Statutit të Komunës së Prishtinës, të dt 31.3.2008, dhe të dispozitave të nenit 24.2 dhe 24.5 të Ligjit për edukimin parashkollor, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 21.5.2008, merr

V E N D I M
PËR LIRIMIN NGA PAGESA PËR KATEGORITË E CAKTUARA TË FËMIJËVE TË
VENDOSUR NË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE PUBLIKE

- I. Lirohen nga pagesa kategoritë e caktuara të fëmijëve të vendosur në institucionet parashkollore publike si vijon:
- a) Fëmijët e invalidëve të luftës dhe fëmijët bonjakë (pa të dy prindërit) lirohen nga pagesa 100%;
 - b) Fëmijët me njërin prind lirohen 50%;
 - c) Prindërit që kanë më shumë se një fëmijë në IP të regjistruar, të ardhurat e të cilëve janë nën mesataren e të ardhurave nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës, lirohen 30%;
 - d) Punëtorët e punësuar në IP lirohen nga pagesa për 50% nëse të ardhurat e tyre janë nën nivelin e mesatares së të ardhurave nga Buxhetit i konsoliduar i Kosovës.
- II. Lirimi nga pagesa, si në pikën I të këtij Vendimi, bëhet nga 1 shtatori i vitit 2008.
- III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria e Arsimit dhe e Kulturës e Komunës së Prishtinës, përmes drejtorëve të institucioneve parashkollore.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nr. 400-626, më 21.5.2008

KRYETAR I KOMUNËS
Prof.dr. Isa Mustafa